
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

**KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE**

Nr 570prot

Tiranë, më 7. 10. 2024.

VENDIM

Nr. 7 datë 7.10. 2024

**PËR
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 4/10/2024**

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.910, datë 21.12.2016, “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 4.10.2024 vendosi:

1. Për draftin për amendimin e Ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij” propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të adresohet problematika e zgjedhjes së administratorit si dhe detyrim për pagesat e detyrimeve;
 - Të vihet sa më shpejt në funksion sistemi për menaxhimin e subjekteve të dyta dhe të treat;
 - Të rregullohen mekanizmat për mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që ushtrojnë veprimtari Airbnb

2. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, propozuar nga **Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të shtyhet periudha e legalizimit për ndërtimet e kryera pa leje deri në fund viti 2021 ose dhjetor të vitit 2023


3. Për projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”” propozuar nga **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të zgjatet afati i aplikimit të rregullores;
 - Të përcaktohen saktë distanca që do aplikohet për vijën bregdetare për plazhet publike për secilën bashki dhe të mos jetë e unifikuar për gjitha bashkitë bregdetare apo liqenore;
 - Të lidhen kontratat me subjektet më përpara fillimit të sezonit turistik;
 - Për zbatimin e kësaj VKM-je duhet të futet edhe policia e shtetit pasi bashkia nuk ka mjaftueshëm staf.

4. Për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale” propozuar nga **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.

5. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 926, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar propozuar nga **Drejtoria e Privatizimit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të identifikohen pronat shtetërore që nuk janë të çertifikuara dhe t’i kalohen bashkive, pëfshirë dhe tokat bujqësore dhe ato të kooperativave;
 - Në kontratat “1 euro” duhet të përcaktohet saktësisht se kush e ka detyrimin pasi për sa kohë jepen për “1 euro” është politikë shtetërore mbështetëse e biznesit dhe bashkia duhet të paguhet si dhe të shkruhet në kontratë që e përjashton nga taksat vendore sepse nga taksat vendore nuk të përjashton dot ministria të përjashton vetëm vendimi i këshillit bashkiak;
 - Të jetë bashkia përfituesi i parë i procesit të likuidimit.

6. Për “Portali i ri vendor dhe platforma për dialog” propozuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me portalin.

Z. Arbjan MAZNIKU
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor
Bashkëkryetar



Z. Aldrin DALIPI
Kryetar i Shoqatës së Këshillit
të Qarqeve të Shqipërisë
Bashkëkryetar

